

IMAZHI I KRYENGRITJES SË DERVISH CARËS NË HISTOGRAFINË MAQEDONASE DHE SHQIPTARE

THE IMAGE OF DERVISH CARA UPRISING IN MACEDONIAN AND ALBANIAN HISTORIOGRAPHY

Hasan SALIU¹, Zejni MAZLLAMI²

^{1*} *Master of Arts in History*

^{2*} *Department of History, Faculty of Philosophy, University of Tetova*

**Corresponding author e-mail: hasan.saliu@outlook.com; zejmi.mazllami@unite.edu.mk*

Abstract

One of the largest and most important uprisings in the 40s of the 18th ct. in the predominantly Albanian areas of Macedonia was the uprising led by Dervish Cara. The uprising started in Gostivar, with the city falling to the insurrectionaries in November 1843, followed by Tetova in early January, and Skopje in late February 1844. In the cities captured by the insurrectionaries, Ottoman officials were expelled. The insurrectionaries, under the leadership of Dervish Cara, advanced to Vranje in the spring of 1844.

In Macedonian historiography, the primary source remains the book "The Uprising of Dervish Cara" by the historian Aleksandar Matkovski, which details the commencement, progression, and tragic end of the uprising and its leader. Some Albanian historians who have written about the Dervish Cara Uprising have attempted to attach to it a more political character. In Albanian historiography and textbooks in Albania and Kosovo, Dervish Cara's uprising is not accorded significant attention and importance, in contrast to the historians and textbooks in North Macedonia.

Keywords: historiography, uprising, Dervish Cara, Albanian people, Macedonia.

Përmbledhje

Një nga kryengritjet më të mëdha dhe më domethënëse në vitet '40 të shekullit XIX në rajonet me shumicë shqiptare në Maqedoni ishte kryengritja e Dervish Carës. Kryengritja filloi në Gostivar, qyteti ra në duart e kryengritësve në nëntor 1843, Tetova në fillim të janarit dhe Shkupi në fund të shkurtit 1844. Në qytetet që u morrën nga kryengritësit, zyrtarët osmanë u dëbuan. Kryengritësit e udhëhequr nga Dervish Cara arritën në Vranjë në pranverë të vitit 1844.

Në historiografinë maqedonase, burim kryesor mbetet libri Kryengritja e Dervish Carës e historianit Aleksandër Matkovski, i cili përshkruan fillimin, rrjedhën dhe fundin tragjik të kryengritjes dhe udhëheqësin e saj. Disa historianë shqiptarë që kanë shkruar për Kryengritjen e Dervish Carës, janë përpjekur ti japin një karakter më politik. Kryengritjes së Dervish Carës në historiografinë shqiptare dhe tekstet shkollore në Shqipëri dhe Kosovë, nuk i jepet hapësirë dhe rendësi e veçantë për dallim nga historianët dhe tekstet shkollore në Maqedoninë e Veriut.

Fjalët kyçe: historiografi, kryengritje, Dervish Cara, popullata shqiptare, Maqedoni.

Kryengritja e Dervish Carës sipas histografisë maqedonase

Në historiografinë maqedonase, burim kryesor dhe vepër e paçmuar mbetet libri i titulluar *Kryengritja e Dervish Carës* e historianit Aleksandar Matkovski. Një burim shumë i dobishëm janë *Dokumentet britanike për historinë e popullit maqedonas*, vëllimi II (1840-1847). Për disa aspekte ose e kanë përmendur në punimet e tyre shkencore Risto Poplazarov, Dalibor Jovanovski dhe tjerë. Vepra *Kryengritja e Dervish Carës* e Matkovskit,²²⁰ e shkruar në vitin 1980, e botuar për herë të parë si përkthim në shqip në vitin 1985, është ripërkthyer në shqip në vitin 2012.

Sipas Matkovskit, Kryengritja e Dervish Carës nuk duhet parë si një ngjarje e izoluar, por në kuadër të kryengritjeve të mëparshme shqiptare. Si arsye për shpërthimin e kryengritjes, Matkovski ndër të tjera përmend: Zbatimin e Hatisherifit e Gjylhanes më 1839; Zbatimi i ligjit të ri për riorganizimin e ushtrisë turke; Rritja e taksave; megjithatë, arsyeja kryesore ishte likuidimi i pashallarëve të Tetovës: Hivzi Pashës në Shkup, Hisen Pashës në Qystendil dhe Abdurahman Pashës në Tetovë. Kryengritja përfundoi pa sukses, mungesa e një klase shoqërore për të udhëhequr kryengritjen, mungesa e një aleance me popullsinë jomuslimane dhe mungesa e mbështetjes dhe ndihmës ndërkombëtare.

Matkovski beson se kryengritja kishte disa karaktere, përkatësisht: Karakteri etnik: kryengritësit kishin një vetëdije të mirëformuar për origjinën e tyre; Karakter islam: jo në kuptimin fetar, por nga sfondi fetar i pjesëmarrësve të tij; Karakteri antitanzimat: sepse kryengritësit ishin kundër reformave që preknin traditat shqiptare; Karakteri nacional-çlirimtar: sepse shqiptarët i konsideronin turqit të huaj dhe të tjerë. Në një vepër tjetër Aleksandar Matkovski shkruan se: Bektashinjtë nuk do të përmenden askund si një nga arsyet e fillimit të kryengritjes. Megjithatë, ata ishin pjesë e kryengritjes dhe sigurisht luajtën një rol të rëndësishëm.²²¹

Përpos Matkovskit, këtë kryengritje e përmend edhe historiani Hristo Andonov-Poljanski në artikullin *Shtojcë e marrëdhënieve maqedono-shqiptare në të kaluarën*. Situata e krijuar rebele nxiti dhe aktivizoi forcat kryengritëse për të luftuar kundër tiranisë. Ajo gjeti një shprehje të veçantë gjatë lëvizjes kryengritëse të Dervish Carës nga viti 1843-1844. Lëvizjes së tij iu bashkua edhe popullata maqedonase, e cila konfirmoi reciprocitetin në veprën çlirimtare.²²² Historiani maqedonas Risto Poplazarov shkruan për pjesëmarrjen dhe tërheqjen e krishterëve në Kryengritjen e Dervish Carës. Sa i përket pjesëmarrjes të krishterëve, ajo përmendet vetëm në një raport të konsullit rus në Manastir, M. A. Hitrovo i vitit 1862. Sipas tij, në kryengritje fillimisht morën pjesë disa nga krishterët, por pasi kryengritësit filluan dhunën ndaj tyre, ata u tërhoqën.²²³

Në *dokumentet britanike për historinë e popullit maqedonas*, për betejën e fundit shkruhet: Beteja vendimtare midis kryengritësve dhe ushtrisë së sulltanit të komanduar nga Omer Pashë Latasi u zhvillua afër Katllanovës, midis 18 dhe 19 maj 1844. Kryengritësit luftuan me trimëri, por siç theksojnë konsujt e huaj nga Selaniku, nuk kishin asnjë shans kundër ushtrisë së rregullt osmane, e cila ndryshe nga ata ishte edhe shumë e disiplinuar, edhe e stërvitur dhe kishte artileri. Dervish Cara u kap gjatë betejës së Katllanovës. Këtë e mësuam nga raporti i konsullit britanik më 23 maj 1844.²²⁴

²²⁰ Aleksandër Matkovski, *Kryengritja e Dervish Carës* (përktheu Fatmir Sulejmani), Tetovë, 2012.

²²¹ Александар Матковски, *Отпорот во Македонија во време на турското владеење*, Том IV, Скопје, 1983, стр. 790.

²²² Христо Андонов Полјански, *Прилог кон македонско-албанските врски во минатото*. Годишен зборник на Филозофскиот факултет 33, (1981), стр. 19–20.

²²³ Ристо Поплазаров, *Еден интересен документ за Бунтот на Дервиш Цара*, Гласник ИНИ, Скопје, 1974, бр. 1, стр. 213.

²²⁴ Христо Андонов Полјански, *Британски документи...II*, Христо Андонов-Полјански. *Британски документи за историјата на македонскиот народ*, том II (1840-1847), Скопје, 1976. бр. 91, стр. 135.

Për fatin e Dervish Carës pas kryengritjes shkruajnë historianët maqedonas Aleksandër Matkovski dhe Poliksena Angelokova. Dervish Cara u dërgua në internim në Stamboll nëpërmjet Selanikut, ku edhe vdiq. Nuk dihet saktësisht viti i vdekjes së tij, por ai përmend se ishte gjallë vitin e ardhshëm, 1845, ku u pa si i burgosur.²²⁵ Vitin e fundit për Kryengritjen e Dervish Carës ka shkruar edhe historiani Dalibor Jovanovski, i cili qysh në fillim të shkrimit shkruan fjalë lavdëruese për monografinë e Matkovskit, sepse ai ishte autori i parë për Kryengritjen e Dervish Carës, pavarësisht faktit se kjo kryengritje filloi në Maqedoni, e më pas u shtri në Kosovë, Serbinë Jugore dhe Shqipërinë, nuk ishte objekt trajtimi monografik as në Serbi, as në Shqipëri e as në Maqedoni.

Jovanovski na jep të dhëna interesante se kjo kryengritje, përveçse është shënuar në raportet dhe korrespondencën e diplomatëve, u vu re dhe u analizua në gazetata dhe historianët prestigjioze evropiane.²²⁶ Në botimin *Historia e popullit maqedonas*, të botuar nga Instituti për Histori Kombëtare, nuk përmendet Kryengritja e Dervish Carës. Ndoshta për faktin se e gjithë historia e popullit maqedonas është vendosur në një vëllim të vetëm.²²⁷ Sipas autorëve Eshtref Emini dhe Luben Lape, Kryengritja e Dervish Carës ishte ndër të tjera një reagim ndaj fushatës së Hajredin Pashës.²²⁸

Kryengritja e Dervish Carës sipas histografisë shqiptare

Nga historianët shqiptarë për aspekte të ndryshme të Kryengritjes së Dervish Carës kanë shkruar: Ali Vishko, Masar Kodra, Vebi Xhemaili (Maqedoni), Ligor Mile, Petrika Thëngjilli (Shqipëri), Bedrush Shehu, Jusuf Buxhovi, Ardian Emini (Kosovë) e të tjerë. Historiani Ali Vishko shkruan shkurt për shkaqet e kryengritjes: „Pas vitit 1840, në viset të banuara me shumicë të popullatës shqiptare, Porta e Lartë cakton për administratorë cakton pashallarët dhe funksionarët joshqiptarë, që nuk dinin gjuhën shqipe dhe doket e zakonet të vendit, etj”.²²⁹

Sipas Masar Kodrës, këto sjellje të Perandorisë Osmane, ndër të tjera kërcënonin: „ruajtjen e identitetit të popullit shqiptar, ruajtjen e gjuhës shqipe, ruajtjen e kulturës, traditës dhe historisë shqiptare, ruajtjen e autonomisë shqiptare nëpër krahinat apo territoret e tjera shqiptare”.²³⁰ Në botimin e fundit të Institutit të Historisë në Tiranë, të titulluar *Historia e popullit shqiptar* është shkruar shkurt për Kryengritjen e Dervish Carës, e cila është një vërejtje e përgjithshme e disa historianëve shqiptarë (sidomos nga Maqedonia). Përveç emrit të Dervish Carës, jepen edhe emrat e komandantëve të tjerë që udhëhoqën kryengritjen si: Emin Xhambazi, Sulejman Toli (Tërnovci), Selman Rogoçica, Emin Bojana, Imer Presheva, Baba Feka, Sejdi Mexha, Bajram Vaksinca etj.²³¹

Autori Zeqirja Neziri ka analizuar shtypin serb për Kryengritjen e Dervish Carës. Sipas tij, edhe pse shtypi serb i asaj kohe (“Srbske novinine” dhe “Srbske narodni novinine”) ishte i ndikuar nga politika e mbretërisë serbe të Obrenoviqit, e cila kryengritjet shqiptare antiosmane i quajti pakënaqësi të rajonit të uritur apo të pakënaqur kryengritës, duke u përpjekur të minimizojnë kryengritjet shqiptare me karakter kombëtar.²³² Dy interpretime interesante jep historiani Vebi Xhemaili.

²²⁵ Александар Матковски & Поликсена Ангелокова, *Патувањето на двајца Англичани низ Македонија во 1839, 1842 и 1844 година*, ГИНИ, год. XVIII, бр. 1, Скопје, 1974, стр. 249.

²²⁶ Далибор Јовановски, *Востанието на Дервиш Царе (1843-1844)*, во: *Востанијата во Македонија*, Филозофски факултет, УКИМ, Скопје, 2015, стр. 117-125.

²²⁷ Институт за национална историја, *Историја на македонскиот народ*, Скопје, 2008.

²²⁸ Ештреф Емини & Лубен Лапе, *Тетово и Тетовско низ историјата*, Скопје, 1982, стр. 235.

²²⁹ Ali Vishko, *Teqeja Harabati e Tetovës dhe veprimtaria në të një periudhën e kaluar*, Tetovë, 1997, f. 62.

²³⁰ Masar Kodra & et al. *Kërkime Historike 2*, Shoqata e Historianëve Shqiptar në Maqedoni, Shkup, 1996, f. 54.

²³¹ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Historia e popullit shqiptar*, v. II, Tiranë, 2002, f. 93.

²³² Zeqirja Neziri, *Kryengritja Dervish Carës në shtypin serb të kohës*, në: *Pollogu nëpër shekuj*, Tetovë, 1994, f. 69.

E para, Kryengritja e Dervish Carës ishte një kryengritje e përgjithshme dhe kryengritja e parë në të cilën morën pjesë më shumë se 70% e krahinave të banuara me shqiptarë. Historiografia shqiptare nuk dha peshën e merituar që ka kjo kryengritje kombëtare në historinë kombëtare. Së dyti, kjo kryengritje, në bazë të rrjedhës së saj, mund të konsiderohet thjesht si kryengritja e parë fshatare, sepse në këtë lëvizje nuk kishte drejtues nga lart, por ata vinin nga vetë populli. Xhemaili, ndryshe nga shumë historianë maqedonasë dhe shqiptarë, mohon që Kryengritja e Dervish Carës të jetë përkrahur nga bashkëqytetarë joshqiptarë dhe të krishterë, përkundrazi kanë qenë kundër. Krahas historiografisë shqiptare, ai ka një qasje kritike edhe ndaj historiografisë maqedonase, e cila, sipas tij, prej kohësh manipulon origjinën e Dervish Carës, duke shkruar se “ai është me origjinë sllavo-myslimane”, sepse familja jetonte në fshatin Urviç.²³³

Historiani Ardian Emini ka një interpretim tjetër të ngjarjeve. Sipas tij, Kryengritja e Dervish Carës filloi në Shkup më 21 korrik (dhe jo në Gostivar e Tetovë) dhe u përhap në gusht të vitit 1843, kur me ardhjen e forcave osmane nën udhëheqjen e Hajredin Pashës u shtuan përpjekjet për rekrutimin e ushtarëve të rinj. Në fillim të shkurtit 1844 kryengritësit e udhëhequr nga Bajram Vaksinca çliruan Kumanovën. Popullsia sllave e Kumanovës iu bashkua kryengritësve. Ndër të tjera kryengritësit kërkuan autonominë e shqiptarëve në Perandorinë Osmane.²³⁴

Kryengritja e Dervish Carës në librat e historisë

Është fakt i pamohueshëm se në tekstet e historisë shkruhet më shumë për historinë e përgjithshme të shqiptarëve, dmth. për historinë e shqiptarëve në Shqipëri, më pak për shqiptarët në Kosovë dhe pothuajse asgjë për historinë e shqiptarëve etnikë në Republikën e Maqedonisë. Në këtë mënyrë krijohet përshtypja se persona nga populli shqiptar në Maqedoni nuk kanë marrë pjesë në ngjarjet e përditshme në shtetin maqedonas gjatë historisë, gjë që është krejtësisht në kundërshtim me gjendjen reale.

Në planin mësimor për lëndën Histori, të përgatitur nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë, në planprogramin e vjetër (2004) si dhe në atë të ri (2019), Kryengritja e Dervish Carës është pjesë e kurrikulës për klasën e shtatë dhe të tetë, me titull: *Shqiptarët në kohën e Tanzimatit*.²³⁵

Teksti shkollor për klasën e 8 nga autorët Violeta Ačkoska, Vanço Gjeorgiev, Fejzulla Shabani, Dalibor Jovanovski nga viti 2005, ndër shumë ngjarje, shkurtimisht shkruan edhe për Kryengritjen e Dervish Carës.

Teksti shkollor për vitin e dytë të gjimnazit (botimi i tretë) i autorëve Milan Boshkoski, Nebi Dervishi, Silvana Sidorovska-Çupovska, Natasha Kotlar, Jordan Ilioski, Dimko Popovski nga viti 2018, informacion për Kryengritjen e Dervish Carës jepet nën mësimi me titull Tanzimati dhe kryengritjet e shqiptarëve.

Historia e Maqedonisë për vitin e dytë të arsimit të mesëm profesional nga autorët Miroslav Boshkoviq, Dançe Maçevska nga viti 2010. Kryengritja e Dervish Carës nuk gjendet në këtë libër shkollor.

²³³ Vebi Xhemaili, *Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut në luftë për pavarësi kombëtare (1844-1914)*, Tetovë, 2019, f. 86-89.

²³⁴ Ardian Emini, *Presheva në rrjedhat e historisë- shek XX* (punim doktorature), 2014, f. 19-20.

²³⁵ Byroja për zhvillimin e Arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Planprogrami për lëndën e Historisë, për klasën e tetë të arsimit nëntëvjeçar, në: <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2019/07/Nastavna-programa-Istorija-VIII.pdf> 15; Byroja për zhvillimin e Arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Planprogrami për lëndën e Historisë, për klasën e tetë të arsimit tetëvjeçar, në: https://edumedia-depot.gei.de/bitstream/handle/11163/4065/889_503494_2004_A.pdf?sequence=2

Ndër tekstet shkollore në Kosovë, Kryengritja e Dervish Carës është paraqitur në tekstin Historia 11 (teksti shkollor për vitin e tretë të gjimnazit) të autorëve Ramiz Abdulë dhe Emine Bakalli, botuar në Prishtinë në vitin 2012. Kryengritja paraqitet si një revoltë e popullsisë shqiptare kundër reformave të Tanzimatit dhe njëkohësisht kryengritësit kishin kërkesa politike. Kryengritja e Dervish Carës është paraqitur në tekstet e historisë për arsimin fillor dhe të mesëm, por pa i dhënë rëndësi, ose ka një përshkrim të shkurtër ose vetëm përmendet.

Në librin e parë Historia 8 (teksti mësimor për klasën e 8) të disa autorëve nën redaksinë e Muzafer Korkutit, Kryengritja e Dervish Carës është paraqitur në kapitullin e gjashtë të shkruar nga Petrika Thëngjilli i cili shkruan se udhëheqësi i kryengritjes ishte Dervish Cara dhe numri i kryengritësit arritën në dhjetë mijë. Mirëpo, sipas autorëve, kjo kryengritje nuk ishte më e madhja nga kryengritjet shqiptare të kësaj periudhe, më e madhe ishte kryengritja e Shqipërisë së Jugut më 1847 e udhëhequr nga Zenel Gjoleka. Më shumë se historianët shqiptarë nuk janë dakord me këtë përfundim.

Në dy librat Historia 9 (teksti për vitin e parë të gjimnazit) të disa autorëve, i pari nën redaksinë e historianit Neritan Ceka dhe i dyti nën redaksinë e Menduh Dërgutit përmendet Kryengritja e Dervish Carës. shumë shkurt me dy-tri fjali pa informacione të rëndësishme.

Përfundimi

Në vitin 1839, për shkak të pakënaqësisë me zbatimin e reformave të Tanzimatit, në mbarë Ballkanin filluan të shfaqen kryengritje dhe rebelime. Këtyre pakënaqësive iu bashkua edhe popullsia myslimane e udhëhequr nga bejlerët, pashallarët dhe ulematët. Në vitin 1843 filluan të zbatoheshin reforma edhe në Rumeli. Ndër kryengritjet më të njohura ishte kryengritja e udhëhequr nga Dervish Cara, e cila shpërtheu në Gostivar dhe u përhap në Vranjë e Leskoc. Kryengritësit kishin edhe kërkesa politike.

Në botimet në Shqipëri dhe Kosovë, është shkruar shkurt Kryengritja e Dervish Carës, e cila është një vërejtje e përgjithshme e disa historianëve shqiptarë (sidomos nga Maqedonia). Si përfundim, Kryengritjes së Dervish Carës i kushtohet më shumë rëndësi në tekstet shkollore të Historisë të shtypura në Maqedoni sesa ato në Kosovë dhe Shqipëri.

Referencat

- [1]. Akademia e Shkencave të Shqipërisë. (2002). *Historia e popullit shqiptar*, v. II, Tiranë.
- [2]. Андонов Полјански, X. (1976). *Британски документи за историјата на македонскиот народ*, том II (1840-1847), Скопје.
- [3]. Андонов Полјански, X. (1981). *Прилог кон македонско-албанските врски во минатото*. Годишен зборник на Филозофскиот факултет, бр. 33, Скопје.
- [4]. Емини, Е. & Лапе, Ј. (1982). *Тетово и Тетовско низ историјата*, Скопје.
- [5]. Emini, A. (2014). *Presheva në rrjedhat e historisë- shek XX* (punim doktrature) në: <https://www.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/04/Doktoratura-Ardian-Emini-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Historise.pdf>
- [6]. Институт за национална историја. (2008). *Историја на македонскиот народ*, Скопје.
- [7]. Јовановски, Д. (2015). *Востанието на Дервиш Царе (1843-1844)*, во: *Востанијата во Македонија*, Скопје: УКИМ, Филозофски факултет.
- [8]. Kodra, M. & et al. (1996). *Kërkime Historike 2*, Shoqata e Historianëve Shqiptar në Maqedoni, Shkup.
- [9]. Матковски, А. & Ангелкова, П. (1974). *Патувањето на двајца Англичани низ Македонија во 1839, 1842 и 1844 година*, ГИНИ, год. XVIII, бр.1, Скопје.
- [10]. Матковски, А. (1983). *Отпорот во Македонија во време на турското владеењето*, Том IV, Скопје.
- [11]. Matkovski, A. (2012). *Kryengritja e Dervish Carës* (përktheu Fatmir Sulejmani), Tetovë.
- [12]. Neziri, Z. (1994). *Kryengritja Dervish Carës në shtypin serb të kohës*, në: *Pollogu nëpër shekuj*, Tetovë.
- [13]. Поплазаров, Р. (1974). *Еден интересен документ за Бунтот на Дервиш Цара*, Гласник ИНИ, Скопје.
- [14]. Vishko, A. (1997). *Teqeja Harabati e Tetovës dhe veprimtaria në të në periudhën e kaluar*, Tetovë.
- [15]. Xhemaili, V. (2019). *Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut në luftë për pavarësi kombëtare (1844-1914)*, Tetovë.

- [16]. Byroja për zhvillimin e Arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Planprogrami për lëndën e Historisë, për klasën e tetë të arsimit nentëvjeçar, në: <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2019/07/Nastavna-programa-Istorija-VIII.pdf> 15
- [17]. Byroja për zhvillimin e Arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Planprogrami për lëndën e Historisë, për klasën e tetë të arsimit tetëvjeçar, në: https://edumedia-depot.gei.de/bitstream/handle/11163/4065/889503494_20_04_A.pdf?Sequenze=2